



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

u.d. Rektor

Prof. Dr. Anton Berishaj

Nr. Prot.: 1109

Datë: 9 / 6 / 2014

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 68.1 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 9.6.2014 mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë (ref. nr. 3129, datë 15.5.2014) për zgjedhjen e prof. dr. Salih Ahmetit dekan të Fakultetit të Mjekësisë.
- II. Prof. dr. Salih Ahmeti do ta kryejë detyrën e dekanit të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën e mbetur të mandatit të dekanit, përkatësisht deri më 30.9.2016.
- III. Dekani i Fakultetit do të kompensohet për punën e tij në përputhje me Rregulloren përkatëse në fuqi.

Arsyetim

Bazuar në nenin 68.1 të Statutit të UP-së, Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, në mbledhjen e mbajtur më 13.5.2014, unanimisht e ka zgjedhur dekan të Fakultetit të Mjekësisë prof.dr. Salih Ahmetin, të cilin ia ka propozuar Senatit të UP-së për miratim.

Pas anulimit të aktvendimit C.nr. 468/14 të lëshuar nga Gjykata Themelore, me të cilin kjo gjykatë kishte caktuar masa të përkohshme të sigurimit, si dhe duke u mbështetur në nenin e sipërhënuar, Senati i UP-së, me shumicë absolute të votave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Prof. dr. Salih Ahmetit;
3. Shërbimit të financave të FM-së;
4. Zyrtarit ligjor të UP-së.



Prof. dr. Anton Berishaj

U. d. rektorit të UP-së